



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.12.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti me nr.APK-DPKI-06-1175/24, për zyrtaren znj. *Afrodita Gashi, Drejtor i Burimeve Njerëzore në Universitetin "Haxhi Zeka"* lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i jashtëm për konflikt të mundshëm të interesit përkitazi me konkursin publik Nr. 1967/3, të datës 29.07.2024, të shpallur nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi lidhur me konkursin publik Nr. 1967/3, të datës 29.07.2024, të shpallur nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), ku janë ngritur pretendimet se: "[...] Kandidatja e përmendur: znj. A.G., ka qenë ushtruese e detyrës për këtë pozitë deri një ditë para përfundimit të konkursit. Sekretarja e Universitetit: T.B., familjare e znj. A.G. në lidhje gjinie të krushqisë".

Tutje, raportuesi i rastit ka bërë përshkrimin e situatës si në vijim:

"Krijimi i Kushteve të Konkursit: znj. A.G. ka qenë përgjegjëse për hartimin e kushteve dhe kriterëve të konkursit për pozitën që aplikon vetë. Ky veprim është një konflikt flagrant i interesit, pasi ajo ka pasur mundësi të përshtatë kushtet e konkursit në mënyrë që të favorizonte veten.

1. Miratimi i Kushteve nga Sekretarja: Kushtet dhe kriteret e konkursit janë dërguar për miratim të Sekretares së Universitetit, T.B., e cila është familjare me Znj. A. G. Ky fakt ka ngritur dyshime të forta për objektivitetin e Procesit të Vlerësimit.

2. *Formimi i Komisionit të Vlerësimit: Komisioni që ka udhëhequr procedurën e rekrutimit është formuar nga T.B., e cila është përgjegjëse për miratimin e kandidatëve, duke sjellë pyetje në lidhje me objektivitetin dhe drejtësinë e procesit.*

Këto rrethana krijojnë një situatë të qartë të konfliktit të interesit dhe mund të ndikojnë negativisht në integritetin e procesit të rekrutimit, duke favorizuar individë të caktuar dhe duke cenuar transparencën dhe drejtësinë e këtij Procesi. [...]

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimi të informatës si më lartë, si dhe pas vlerësimit paraprak të rastit, sipas procedurës së paraparë fillimisht me shkresën zyrtare APK-DPKI-02/1258/24, ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit “Haxhi Zeka” informata, sqarime dhe dokumentacionin lidhur me konkursin publik Nr. 1967/3, të datës 29.07.2024, të shpallur nga Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë. Duke vepruar sipas kërkesës në fjalë, Universiteti “Haxhi Zeka”- Sekretari i Përgjithshëm, ka dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit informatat, sqarimet dhe dokumentacionin përkatës lidhur me konkursin në fjalë.

Në plotësim të informacionit dhe me qëllim të sqarimit të plotë të rastit në fjalë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar dhe ka pranuar dokumentacion relevant nga Agjencia e Regjistrimit Civil në lidhje me verifikimin për vërtetësinë familjare lidhur me zyrtaret e përmendur në këtë rast (shkresa zyrtare: DPKI-01-1764/243, DPKI-02-1539/24).

Pas trajtimit të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konstatoi si në vijim:

Në rastin konkret, sipas vlerësimit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në Institucionet përkatëse, rezulton që, u.d. Sekretari i Përgjithshëm në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, znj. T.B. dhe kandidatja e përzgjedhur znj. A. G., nuk janë persona të afërm në kuptim të dispozitës përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (neni 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6).

Ndërsa, sa i përket pretendimeve të raportuesit të rastit lidhur me krijimin e Kushteve të Konkursit nga A.G., Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar se *Kriteret dhe Kualifikimet Profesionale*, të konkursit janë hartuar sipas Rregullores për Përshkrimin e Vendeve të Punës në Administratën e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë (14. Zyra për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore, 14.1 Drejtor i Zyrës), duke mos lënë kështu hapësirë për krijim apo përshtatje subjektive të kushteve të konkursit.

Gjithashtu, pretendimi se T.B. ka formuar Komisionin e Vlerësimit, në rastin konkret, nuk është relevant, pasi që, sikurse u konstatua mësipër, T.B dhe A.G., nuk janë persona të afërm, fakt ky që e përjashton konfliktin e interesit në kuptim të nenit 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në sqarim më të hollësishëm të kësaj çështje, Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konkretisht neni 6 të ka përkufizuar nocionin e konfliktit të interesit, ashtu që:

“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:



"1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

si dhe me nën-paragrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është - bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin.[...]"

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nocionin vendimmarrje si:

"Çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."


Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të, në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin, ndërsa sa i përket pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara të jenë plotësuar këto dy kushte kumulative, siç është vendimmarrja dhe interesi privat në çështjen konkrete.

Prandaj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit lidhur me rastin e raportuar përkitazi me konkursin publik Nr. 1967/3, të datës 29.07.2024, të shpallur nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit